

Ministri i Shtetit

MINISTRIA SHETETERORE SAKSONE PËR ARSIM  
Kutia Postare 10 09 10 | 01079 DresdenDrejtuar të gjithë prindërve  
të nxënësve  
të shkollave publike  
në Shtetin e Lirë të Saksonisë (Sachsen)Për informacion:Të gjithë prindërve të nxënësve  
të shkollave private

Dresden, 23 prill 2021

**Ndryshime në shkollë duke filluar nga data 26 prill 2021**Të nderuar zonja dhe zotërinj,  
të dashur prindër!

S'ka shumë që jemi njoftuar, se duhet të përgatitemi sërish për kufizime të mëdha në shkollë, të cilat do të ndikojnë kryesisht tek fëmijët. E di, se sa e rëndë është për familjet kjo barrë dhe sa shqetësoheni për zhvillimin e fëmijëve tuaj. Me ndryshimin e ligjit për mbrojtjen ndaj infeksionit, ligjvënësi federal nuk na lë më hapësirë për të ofruar mësim në prezencë në të gjitha shkollat. Rregullorja për mësimin me turne kur ka një incidencë mbi 100 dhe ndalimi i mësimin në prezencë kur ka një incidencë mbi 165 vlejën menjëherë që tani.

Si mësueset dhe mësuesit, ashtu edhe ne në Ministrinë Shtetërore Saksonë për Arsim do të vazhdojmë të bëjmë ç'është e mundur, për t'iu mundësuar fëmijëve tuaj shanse të mira për një mësimnxënie të vazhdueshme edhe një këtë situatë.

Drejtoreshës ose drejtorit tuaj i kemi dhënë këshilla konkrete për t'i aplikuar. Ata do ta organizojnë shkollën së bashku me këshillin pedagogjik në përshtatje me kushtet krejt të ndryshme të personelit dhe të hapësirave që ka në çdo shkollë. Nëse mësimi në prezencë lejohet në formën me turne, atëherë shkollat do të orientohen sipas rregulloreve të vlefshme që nga mesi i marsit 2021.

Detyrimi që na është vënë nga ligjvënësi federal, për të bërë mësim me turne në shkollat fillore na vë si ne dhe shkollat, po ashtu edhe familjet në një situatë tepër të vështirë. Neve na duhet ta hedhim poshtë komplet konceptin e grupeve/klasave fikse që kishim caktuar. Shkollat fillore duhet të planifikojnë njëkohësisht mësimin, përkujdesjen në rast nevojë dhe përkujdesjen e zakonshme pas shkolle (Hort-in) – të shumtën e herës në të njëjtin vend. Për të siguruar nevojën e madhe për personel, jemi kujdesur që të mund të angazhojmë, në mënyrë krejt unburokratike, edhe forcë punë shtesë. Megjithatë, fatkeqësisht kjo nuk mund të organizohet në krejt pak ditë. Lutemi të keni mirëkuptim, se zgjidhjet njëherë duhet t'i gjejmë dhe pastaj t'i përmirësojmë vazhdimisht.

faqe 1 nga 2

 MACH  
WAS  
WICHTIGES  
Arbeiten im Öffentlichen Dienst Sachsen**Adresa e institucionit:**  
Sächsisches Staatsministerium  
für Kultus  
Carolaplatz 1  
01097 Dresden[www.smk.sachsen.de](http://www.smk.sachsen.de)**Transporti publik:**  
I arrireshëm me linjat e  
tramvajit 3, 7, 8Informacione rreth aksesit për  
dokumentet e nënshkruara në  
mënyrë elektronike si dhe për  
dokumentet elektronike të koduara i  
gjeni tek adresa:  
[www.smk.sachsen.de/kontakt.htm](http://www.smk.sachsen.de/kontakt.htm)

Në fazën e mësimit me turne, mësimi në prezencë dhe koha e mësimit në shtëpi duhet të ndërthuren me njera-tjetrën. Koha e mësimit në shtëpi duhet të ndihmojë, që materiali mësimor i marrë në mësimin në prezencë të ushtrohet dhe të fiksohet më tej. Për këtë gjë, nxënësit natyrisht që do të marrin edhe detyra. Gjatë kësaj kohe, mësuesit nuk do të mund t'i shoqërojnë nxënësit aq intensivisht, si në kohën kur mësimi bëhej vetëm në shtëpi, pasi në kohën kur fëmija juaj mëson në shtëpi, mësuesit duhet t'i japin mësim në prezencë gjysmës tjetër të klasës.

Përdorimin intensiv të platformës mësimore LernSax e kemi siguruar me një hapësirë rezervë shtesë dhe i kemi zgjeruar edhe një herë ndjeshëm kapacitetet e ruajtjes. Në fazat kur, përveç klasave diplomuese dhe klasave të 4-ta, nuk është i mundur mësimi në prezencë, përkrahja nga ana e shkollës është veçanërisht e rëndësishme. Nivelin i performancës për organizimin e mësimit në shtëpi e kemi komunikuar që në muajin shkurt.

Për të kompensuar deficitet e dijës dhe të kompetencave kemi përpiluar tashmë një plan. Për këtë vit janë përcaktuar përmbajtje të reduktuara mësimore, në mënyrë që fëmijët të mund të arrijnë sa më shumë të jetë e mundur në një nivel të përbashkët. Edhe vitin tjetër shkollor, mësuesve do t'u jepet hapësira e nevojshme për të përmbushur nivelet e ndryshme mësimore të nxënësve. Nxënësit do ta kompensojnë mësimin e prapambetur.

Në blog-un tonë, [www.bildung.sachsen.de/blog](http://www.bildung.sachsen.de/blog), kemi vendosur për ju informacione nga më të ndryshmet në lidhje me organizimin e shkollës duke filluar nga dita e hënë.

Kjo është një situatë e vështirë për të gjithë. Drejtoritë e shkollave janë të detyruara t'i aplikojnë rregulloret. Me gjithë këshillin pedagogjik ata bëjnë më të mirën e tyre.

Me angazhim, do t'ia dalim që ta përfundojmë mirë këtë vit shkollor. Lutemi, të vazhdoni t'i motivoni fëmijët tuaj të mos heqin dorë. Jepuni mbështetje dhe optimizëm.

Juve dhe familjeve tuaja ju uroj gjithë të mirat dhe shumë forcë. Paçi besim dhe shëndet.

Me nderime!



Christian Piwarz